



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË _____.202__

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR TRAJTIMIN E
GRAVE/VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË PAJISUR ME URDHËR
MBROJTJE, ME STREHIM TË MENJËHERSHËM.**

Në zbatim të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/2012, Direktivës (BE) 2024/1385, datë 14.05.2024, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqes familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 21.05.2024 “Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të gjykojë konform akteve ligjore dhe,

TË VENDOSË

1. Miratimin e procedurës së përshpejtuar për trajtimin me strehim të menjëhershëm dhe/ose subvencionim qiraje të grave/viktimave të dhunës në familje, të cilat ndodhen në situatë rreziku ose nevojë emergjente për strehim, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe nevojës sociale, të kryer nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale të bashkisë Durrës, të pajisur me urdhër mbrojtjeje nga gjykata.
2. Procedura e përshpejtuar dhe masat e strehimit/subvencionimit zbatohen si masa mbrojtëse, parandaluese dhe riintegruese, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) dhe Direktiva (BE) 2024/1385, duke garantuar akses të menjëhershëm dhe efektiv në shërbime mbështetëse, pa barriera procedurale apo kushtëzime disproporcionale.
3. Subvencionimi i qirasë miratohet për aq sa është parashikuar në urdhërin e mbrojtjes, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, referuar kriterëve ligjorë parashikuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, ”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtör
Alncida Broshi

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Drejtör
Diola Xhango

KRYETAR
Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

RELACION

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR TRAJTIMIN E
GRAVE/VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË PAJISUR ME URDHËR
MBROJTJE, ME STREHIM TË MENJËHERSHËM.**

Të nderuar këshilltarë,

Në zbatim të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/2012, Direktivës (BE) 2024/1385, datë 14.05.2024, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqes familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 21.05.2024 “ Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, ju paraqet relacionin si më poshtë:

Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/2012, ndër të tjera ka për qëllim:

- a) mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

- b) kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave;
- c) hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

Konventa e Stambollit, në nenet 18 dhe 23 të saj, detyron autoritetet publike, përfshirë njësitë e vetëqeverisjes vendore, të sigurojnë shërbime mbështetëse të koordinuara dhe strehim të përshtatshëm për viktimat, pa kushte të tepruara procedurale.

Direktiva (BE) 2024/1385 vendos standarde minimale detyruese për shtetet anëtare dhe vendet kandidate, duke kërkuar garantimin e aksesit të menjëhershëm dhe efektiv në shërbime mbështetëse për viktimat, përfshirë strehimin e sigurt dhe ndihmën ekonomike, pa krijuar barriera procedurale.

Në mënyrë të veçantë, Direktiva thekson se mbështetja duhet të ofrohet mbi bazën e vlerësimit të nevojës dhe rrezikut, duke përfshirë edhe ndërhyrjen e autoriteteve vendore dhe shërbimeve sociale.

Në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës, aktet ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028” është miratuar një fond i cili ka për qëllim parësor të sigurojë strehimin e grave/ viktimave të dhunës në familje nëpërmjet subvencionimit të qirasë për viktimat e dhunës në familje të pajisura me urdhër mbrojtje/urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, në vlerën 5.000.000 lekë.

Referuar sa më sipër, përmes këtij relacioni kërkojmë:

1. Miratimin e procedurës së përshpejtuar për trajtimin me strehim të menjëhershëm dhe/ose subvencionim qiraje të grave/viktimave të dhunës në familje, të cilat ndodhen në situatë rreziku ose nevojë emergjente për strehim, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe nevojës sociale, të kryer nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale të bashkisë Durrës, të pajisur me urdhër mbrojtjeje nga gjykata.
2. Procedura e përshpejtuar dhe masat e strehimit/subvencionimit zbatohen si masa mbrojtëse, parandaluese dhe riintegruese, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) dhe Direktiva (BE) 2024/1385, duke garantuar akses të menjëhershëm dhe efektiv në shërbime mbështetëse, pa barriera procedurale apo kushtëzime disproporcionale.
3. Subvencionimi i qirasë miratohet për aq sa është parashikuar në urdhërin e mbrojtjes, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, referuar kriterëve ligjore parashikuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Çdo viktimë e dhunës në familje, e pajisur me urdhër mbrojtje, do të paraqitet pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, duke paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

1. a) Për të dhëna personale të aplikantit:

- i. certifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individ/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
- ii. vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" i ndryshuar:

- i. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ish zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Durrës) për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;
- ii. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës që aplikanti apo çdo pjestar tjetër i familjes në moshë madhore nuk ka aplikuar për legalizim banese.(origjinale)

c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës "b", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" i ndryshuar:

- i) certifikatë familjare;
- ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës "c", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar:

- i. urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;

d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës "ç", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" i ndryshuar :

- i. vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- ii. dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- iii. vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- iv. vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
- v. vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

2. Kontratën e qirasë.

3. Kohëzgjatja e subvencionimit të qirasë do të jetë në përputhje me afatin e kohëzgjatjes së urdhërit të mbrojtjes, jo më shumë se një vit.

Si referencë për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë është marrë VKB nr.41, datë 21.05.2024 “ Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, ku është miratuar vlera e pagesës së qirasë sipas tregut të lirë për struktura përkatëse të apartamenteve, si më poshtë:

- a) Qiraja për strukturën e apartamentit për 1+1, është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/muaj.
- b) Qiraja për strukturën e apartamentit për 2+1, është 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë/muaj.
- c) Qiraja për strukturën e apartamentit për 3+1, është 40 000 (dyzetë mijë) lekë/muaj.

Pas vlerësimit të dokumentacionit në përputhje me sistemin e pikëzimit, Komisioni i Strehimit, Drejtoria e Shërbimeve Sociale merr masat e menjëhershme për trajtimin e rasteve të referuara nga Gjykata. Gjithashtu, theksojmë që viktimat e dhunës në familje, mund të aplikojnë edhe në programet e Strehimit Social i cili bëhet në çdo moment, në portalin e-albania, pranë dritares "Kërkesë për të përfituar nga programet e Strehimit social", në të cilën duhen ngarkuar të gjithë dokumentacionet e kërkuara referuar ligjit nr 22/2018 "Për Strehimin social" i ndryshuar.

Dokumentacionin e kërkuar familjet e gjejnë të publikuar në internet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës ee.durres.gov.al, në seksionin Njoftime, ose mund të paraqiten fizikisht në Zyrën e Mardhënieve me Publikun.

Dokumentacioni i kërkuar duhet ngarkuar në format PDF online në nënseksionin "Dokumenta të tjera" ose "Dokumenta provuese", në dritaren e e-albania të lartëpërmendur.

Ky relacion ka për qëllim të zgjidhë problemin e strehimit të përkohshëm pa vonesë dhe përmes mjeteve juridike civile dhe administrative i të gjitha rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të cilat shkelin integritetin fizik, psikologjik, social, ekonomik, seksual, të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Duke qenë të bindur, se kemi bërë më të mirën të mundshme por jo perfekt, Ju falenderojmë për mirëkuptimin.

DREJTOR

Diola Xhango